

BALKANS JOINT CONFERENCE AND EXHIBITION
ACCELERATING
Change 7-9 NOVEMBER 2023
GOLEM, ALBANIA

*Towards Safe, Reliable
and Sustainable Services*




Strategjia Shtetërore për Ujëra

Rishikimi i parë: 2023-2027

AFRIM LAJÇI
Këshilli Ndërmnistror për Ujëra
Prishtinë, nëntor 2023

KORNIZA INSTITUCIONALE E SEKTORIT



RISHIKIMI I STRATEGJISË PËR UJËRA - SFONDI

- Dokument i planifikimit **afatgjatë** me vizionin dhe objektivat strategjike për zhvillimin e politikave ujore në Republikën e Kosovës.
- Hartuar për **herë të parë** në vitin 2017 për periudhën 2017-2036 bazuar në kërkesat e Ligjit për Ujëra;
- **Me ligj** është paraparë mundësia e rishikimit – çdo 5 vjet;
- Me rishikim janë marrë parasysh **dokumentet relevante** strategjike dhe të politikave (Politika e Qeverisë për Ujëra, Strategjia për Ndryshime Klimatike 2019-2028, Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030 etj.) dhe është ndërlidhur objektivat e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin P. (2020) dhe me Agjendën 2030 (SDG – Objektivi 6).

RISHIKIMI I STRATEGJISË – SFIDAT

- **Rritja e kërkesës për ujë** → rritja e popullsisë urbane dhe industrializimi shoqëruar me degradimin e tokës dhe ujërave
- **Lëvizja drejt menaxhimit të integruar** të pellgjeve lumore → pellgu i lumit një njësi gjeografike që përcakton tërësinë e procesit hidrologjik dhe i kapërcen kufijtë administrativë/shtetëror
- **Përkthimi i ndërgjegjësimit në vullnet dhe kapacitet politik** → nevoja për të rrënjosur ndërgjegjësimin mbi vlerën ekonomike, sociale dhe mjedisore të ujit të politikanët dhe vendimmarrësit

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

- Objektivi 1: Kompletimi i kuadrit ligjor dhe konsolidimi i kornizës institucionale.
- Objektivi 2: Mbrojtja e digave ekzistuese dhe sigurimi afatgjatë i ujit për shfrytëzuesit.
- Objektivi 3: Mbrojtja e ujërave dhe mbrojtja nga ujërat duke siguruar mbrojtjen e ekosistemit dhe popullatës.
- Objektivi 4: Përmirësimi i besueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve ujore.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1:

Kompletimi i kuadrit ligjor institucional

Treguesit	Pika fillestare	Caku për 2025	Caku për 2027
Transpozimi i legjislacionit të BE	Rreth 60%	90%	100%
Përforcimi i kapaciteteve	31	62	87

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1:

Objektivat specifike

- 1. Kompletimi i kuadrit ligjor** për resurset ujore - ligji i ri për menaxhimin e resurseve ujore, ligji për financimin e menaxhimit të ujërave, aktet nënligjore;
- 2. Përmirësimi i kuadrit rregullator** për shërbimet e ujit – legjislacioni për zonat e shërbimit të KRU-ve, krijimi i bazës ligjore dhe i sistemit të certifikimit të personelit të KRU-ve;
- 3. Përforcimi i kapaciteteve inspektuese** në fushën e ujërave – rritja e numrit të inspektorëve nga 3 sa janë aktualisht në 8.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2:

Sigurimi afatgjatë i ujit dhe siguria e digave


Treguesit	Pika fillestare	Caku për 2025	Caku për 2027
Kapacitetet akumuluese	559 mil. m ³ (2021)	559 mil. m ³	575 mil / m ³

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2:

Objektivat specifike

- 1. Siguria dhe monitorimi i rregullt i digave ekzistuese** – instalimi i sistemeve të monitorimit gjeodezik, sizmik, gjeologjik dhe hidrogjeologjik, hidroteknik, si dhe mbledhja dhe përpunimi automatik i të dhënave.
- 2. Zhvillimi i resurseve të reja ujore** – diga e Firajës dhe diga e Kamenicës (deri 2027), diga e Pollatës, diga e Kuçicës, diga e Dragaçinës (pas 2027)

DIGAT E PLANIFIKUARA



OBJEKTIVI STRATEGJIK 3:

Mbrojtja e ujërave dhe mbrojtja nga ujërat

Treguesi	Pika fillestare	Caku për 2025	Caku për 2027
Shkalla e trajtimit të UN urbane	8% kanë qasje	20% e popullatës	35% e popullatës

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3:

Objektivat specifike

- 1. Hartimi i Planeve të Menaxhimit të Pellgjeve Lumore –**
 - PMPL Drini i Bardhë kompletuar, në diskutim publik;
 - PMPL Ibri, Lepenci, Morava e Binçës në proces;
- 2. Kompletimi i rrjetit të monitorimit të ujërave nëntokësore –**
20 puse të hapura dhe 20 të rehabilituara përmes SIDA;
- 3. Mbrojtja e lumenjve nga eksploatimit i pakontrolluar i aluvioneve.**

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3:

Objektivat specifike (ii)

- 4. Trajtimi i ujërave të ndotura urbane** – ndërtimi i ITUN rajonal i Prishtinës 400,000 banorë (Prishtinë, Obiliq, Fushë Kosovë dhe Graçanicë) dhe Mitrovicës (Mitrovicë, Vushtrri, Mitrovicë Veriore dhe Zveçan), pastaj për Gjilanin, Podujevën dhe Ferizajn.
- 5. Mbrojtja e ujërave nga ndotja prej ujërave industriale** – trajtimi i ujërave industriale para shkarkimit (50%) dhe paratrajtimi i ujërave industriale para shkarkimit në kanalizimin publik (80%);
- 6. Shpallja e zonave erozive** – identifikimi i zonave erozive (2025) dhe shpallja e zonave erozive (2027).

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3:

Objektivat specifike (iii)

- 7. Menaxhimi i përmbytjeve** – kompletimi i hartave të rrezikut dhe riskut nga përmbytjet (2024) dhe i planeve të menaxhimit të riskut nga përmbytjet (2027).
- 8. Mbrojtja e burimeve të ujit të pijshëm** – përcaktimi i zonave të mbrojtura sanitare (nga 35 sa janë në 45 deri në vitin 2027) dhe zbatimi i masave mbrojtëse;
- 9. Rregullimi dhe mbikëqyrja e shfrytëzimit të ujit për qëllime afariste** – dhënia me koncesion në shfrytëzim të ujërave për qëllime afariste përmes një konkursi kompetitiv publik.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 4:

Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve ujore

Treguesit	Pika fillestare	Caku për 2025	Caku për 2027
Përqindja e popullatës që furnizohet me ujë 24/7 nga sistemet e KRU-ve	94%	96%	100%
Shkalla e përputhshmërisë me standardet e cilësisë së ujit të pijshëm.	98%	99%	99.5%
Përqindja e popullatës që furnizohet me ujë nga sistemet e KRU-ve	79%	85%	90%

OBJEKTIVI STRATEGJIK 4:

Objektivat specifike

1. **Përmirësimi i furnizimit me ujë në zonat urbane** – problemet e Gjilanit, Ferizajit, Vitisë, Kamenicës, Malishevës, Mamushës, Klinës;
2. **Përmirësimi i furnizimit me ujë në zonat rurale** – integrimi i sistemeve rurale në KRU (zvogëlimi i numrit të sistemeve rurale që nuk menaxhohen nga KRU nga 12% në 3% në vitin 2027);
3. **Zvogëlimi i UPF nga sistemet publike të ujësjellësit** – nga 55% në 46% në vitin 2027.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 4:

Objektivat specifike

- 4. Përmirësimi i besueshmërisë së operimit të kanalizimit të ujërave të ndotura** – rehabilitimi i sistemit të kanalizimit në rajonin e Prishtinës, në rajonin e Pejës, Prizrenit dhe Gjakovës (futja nën menaxhim të KRU-ve të sistemeve të kanalizimit – nga 65% në 77% në vitin 2027);
- 5. Menaxhimi i llumit të ujërave të ndotura** – zvogëlimi i % së llumit që deponohet në deponi nga 100% në 70% në vitin 2027.

NDIKIMI BUXHETOR I ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Viti	Buxheti qendror	Buxheti komunal	Fondet IPA	Grante te tjera	Huatë	Totali
2023	14,197.56				1,000,000	1,014,197
2024	3,981,032			4,417,000	14,900,000	23,298,032
2025	12,382,032			131,250,000	13,350,000	156,982,032
2026				50,000		
2027						
Totali	16,377,261			135,717,000	29,250,000	181,294,261

(*) – Nuk janë përfshi kostot e ndërtimit të digave

(**) – Kostoja e parashikuar për ndërtimin e ITUN Prishtina – 86 mil EUR (e nënvlerësuar)

MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ZBATIMIT

- **MMPHI përgjegjëse për monitorim** sistematik të zbatimit të Strategjisë;
- Me propozim të MMPHI do të krijohet **një grupi koordinues ndërministror** i përbërë nga përfaqësuesit e: MMPHI, KNU, MFPT, ME, MBPZHR, Zyrës së Planifikimit Strategjik, SHUKOS.
- **Raportet për zbatimin e planit të veprimit** – çdo 6 muaj (progresi i arritur, arsyet për vonesa, rreziqet që lidhen me zbatimin e veprimeve, dhe hapat e ardhshëm);
- Në fund të periudhës 5-vjeçare – **vlerësohet arritja e objektivave** strategjike.

Ju falemnderit!

afrim.lajci@rks-gov.net